



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 3, Datë 26.07.2018


**PËR**

**MIRATIMIN E PLANIT TË DETAJUAR PËR ZONËN E RËNDËSISË KOMBËTARE  
MES LAGUNËS SË KARAVASTASË DHE LUMIT SEMAN**

Në mbështetje të neneve 7, 9, 18 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 4, datë 22.06.2018 të KKT-së “Për miratimin e Nismës së Planit të Detajuar të Zonës së Rëndësisë Kombëtare (PDZRK) në Zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë, me propozim të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman.
2. Dokumenti i plotë i Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman përmban:
  - a) *Planin e zhvillimit;*
  - b) *Rregulloren e planit;*
  - c) *Hartat shoqëruese.*

- 
3. Gjatë hartimit të planeve të tjera sektoriale, planeve të detajuara për zona të rëndësishme kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore, projekteve strategjike dhe pilot të zhvillimit, si dhe të tjera të ngjashme me to, autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit në nivel qendror, qarku dhe atë vendor, duhet të bazohen në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare mes lagunës së Karavastasë dhe lumit Seman.
  4. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të planifikimit, që hartohen nga autoritetet përgjegjëse të planifikimit të territorit, me përcaktimet e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësishme Kombëtare mes lagunës së Karavastasë dhe lumit Seman.
  5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Bashkia Divjakë për zbatimin e këtij Vendimi.
  6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDH RAMA**



**MINISTËR I LINJËS**

**DAMIAN GJIKNURI**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**



**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEBIA TOTA**

